



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.83/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Gyltene Sylejmani kryesues, Nenad Lazić dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Robertina Lekaj, duke vendosur lidhur me apelin Kimete Krosa nga Lausanne-Zvicër, të paraqitur kundër vendimit të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për mospërfshirjen në listën e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 28.09.2017, mori këtë:

V E N D I M

PRANOHET si i bazuar apeli i parashtruar nga Kimete Krosa nga Zvicra, **ANULOHET** vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Nr.1762/2017 të datës 22.09.2017 përkitazi me votuesen Kimete Krosa, dhe **URDHËROHET** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që votuesen Kimete Krosa me vendbanim Rue de Geneve,75/1004 Lausanne-Zvicër ta përfshijë në listat e votuesve jashtë Kosovës.

Arsyetim

Me datën 26.09.2017, PZAP-i ka pranuar një apel nga Kimete Krosa nga Zvicra, të dorëzuar nëpërmjet postës me datën 14.09.2017, në të cilën pretendohet se i është refuzuar nga KQZ-ja kërkesa për të votuar edhe pse posedon dokumente valide të Republikës së Kosovës. Parashtruesja e apelit në cilësi të provës ka bashkangjitur ID e Republikës së Kosovës.

Në përgjigjen në apel të datës 27.09.2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), thekson se periudha e aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës ka filluar me 16.07.2017 dhe ka mbaruar me 23.08.2017, ndërsa lista votuese për zgjedhjet lokale 2017, është certifikuar me datën 22.09.2017, me vendimin 1762/2017. Apeluesja Kimete Krosa ka aplikuar për votim jashtë Kosovës, ku KQZ-ja i ka refuzuar aplikacionin për shkak se dosja ka qenë e pa kompletuar si për faktin se dokumenti i identifikimit me afat të skaduar, nuk ka dëshmuar se ka të drejtë të përfshihet në listën votuese jashtë Kosovës pasi që aplikacioni ka qenë i pa nënshkruar.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimit e apelimit, në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli, vlerësoi lejueshmërinë e apelit dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 122 të LZP-së dhe nenin 10 të Rregullës Nr. 02/2015-Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it.

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i bazuar pasi që parashtresja e apelit si dëshmi ka bashkëngjitur ID e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës me datë 31.07.2017, dhe se e njëjta i plotëson kushtet të cilat kërkohen në bazë të nenit 3.1, pika a), të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se: *“votuesi me zotësi juridike jashtë Kosovës mund ta hedh fletëvotimin për zgjedhjet në qoftë se është regjistruar si banorë i përhershëm i Kosovës në Regjistrin Qendror Civil”*, e që në rastin konkret parashtresja e apelit posedon dokumente valide të identifikimit të lëshuara nga Republika e Kosovës dhe njëherit i plotëson kriteret për të qenë pjesë e Listës së Votuesve.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par. 3, 118 par. 1, 122 par. 1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par. 6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.83/2017 më datën 28.09.2017

Kryesuese e Panelit
Gyltene Sylejmani

Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*